

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Go Green SH.P.K.
Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81911036L
Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Sh.1, Ap.33, Tiranë

VENDIM

I

ASABLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me datë **31.01.2023 (DY MIJË E NJËZET E TRE)**, ORA 10:00, në selinë e shoqërisë "Go Green" Sh.p.k. (në vijim referuar si "Shoqëria") me NUIS L81911036L, janë të pranishëm ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- **BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, më datë 15.04.2008, me NIPT nr. K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 12, Tiranë, Shqipëri, ortake dhe zotëruese në masën 100% (njëqind për përçind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj, përfaqësuar rregullisht në përputhje me paragrafin 9.2 (d) të Nenit 9 të statutit të Shoqërisë Balfin Sh.p.k nga administratorja Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë edhe funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakeve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË GO GREEN SH.P.K.;**
- II. TË NDRYSHME;**

Duke kaluar në diskutimin e çështjes të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja operacionale të Shoqërisë kërkohet financimi i saj me një shumë prej 15,500,000 LEK (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë lekë). Financimi do të jepet në formën e kontributit në para në kapitalin e Shoqërisë i cili nga 4,350,000 LEK (katër milion e treqind e pesëdhjetë mijë lekë) do të bëhet **19,850,000 LEK (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë lekë).**

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes në Rendin të Ditës, Ortaku i Vetëm:


VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë Go Green Sh.p.k., (NUIS L81911036L) me 15,500,000 LEK (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë lekë) (“Zmadhimi i Kapitalit”);
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nëshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetem në para. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 4,350,000 LEK (katër milion e treqind e pesëdhjetë mijë lekë) do të bëhet **19,850,000 LEK (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë lekë)**.
- C. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30. Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të “Go Green” Sh.p.k., mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
Go Green SH.P.K.**

KRYETARI



Znj. EDLIRA MUKA

Përfaqësuese ligjore e

BALFIN -Balkan Finance investment Group Sh.p.k.

Sekretar


Znj. EVA VEIZAJ

